



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.845/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: A. K, N K që të dy nga fsh.Doberdol Komuna Pejë për shkak se në bashkëveprim kishin për të kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 dhe nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari N.K ka kryer vepër penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPRK-së dhe i akuzuari A. K. ka kryer dy vepra penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II.Nr.2139/2015 të datës 07.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurores së shtetit Sahide Gashi, të akuzuarve A.K dhe N.K si dhe në mungesë të palëve të dëmtuara B, V dhe K. K, me datë 19.10.2017 mori dhe shpalli si dhe me datë 15.11.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari A. K. i lindur me datë në fshatin Doberdol Komuna Pejë, ku edhe tani jeton, i biri i N dhe nënës A e gjinisë G, ka të kryer shkollën....., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri
2. I akuzuari N. K i lindur me datë në fshatin Doberdol Komuna Pejë, ku edhe tani jeton, i biri i N dhe nënës A, e gjinisë G ka të kryer shkollën....., shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Të akuzuarit A K.dhe N K

I.Me datën 12.11.2015, rreth orës 16:15, në fshatin Doberdol, Komuna Pejë, me dashje dhe me mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarit V. K në atë mënyrë që për derisa i dëmtuari kishte qenë së bashku me të dëmtuarin B dhe K K duke punuar në arat e tyre, të pandehurit me të arritur në vendin e lart cekur fillon mosmarrëveshje në mes të pandehurve dhe të dëmtuarve ku si pasojë e kësaj

mosmarrëveshje të pandehurit e godasin me kmesa këtu të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit, me çrast lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari V K,

-Me çka në bashkëveprim kanë kryer veprë penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 dhe nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuarit N. K,

Për shkak se:

II. Me datën 12.11.2015, rreth orës 16:15 në fshatin Doberdol Komuna Pejë, me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit e kërcënon të dëmtuarin B. K, në atë mënyrë që për derisa i dëmtuari ishte së bashku me të dëmtuarin V dhe K. K duke punuar në arat e tyre dhe pas një bisede të shkurtër acarohet situata me çrast fillimisht i pandehuri N i drejtohet me fjalët se: “a e din se të shti në dhe” e më pas vazhdon i pandehuri A me kërcënimet”,

-Me çka ka kryer veprë penale, të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari A. K,

III. Me datën 12.11.2015, rreth orës 16:15, në fshatin Doberdol Komuna Pejë, me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit e kërcënon të dëmtuarin B. K, në atë mënyrë që për derisa i dëmtuari ishte së bashku me të dëmtuarin V dhe K. K duke punuar në arat e tyre dhe pas një bisede të shkurtër acarohet situata me çrast fillimisht i pandehuri N i drejtohet me fjalët se: “a e din se të shti në dhe” e më pas vazhdon i pandehuri A me kërcënimet duke ju drejtuar me fjalët se: “a e din se ta heki kryet kmese”,

- Me çka ka kryer veprë penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari A. K,

IV. Me datën 12.11.2015 rreth orës 16:15 në fshatin Doberdol Komuna Pejë me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit e kërcënon të dëmtuarin K. K, në atë mënyrë që për derisa i dëmtuari ishte së bashku me të dëmtuarin V dhe K. K duke punuar në arat e tyre dhe pas një bisede të shkurtër acarohet situata me çrast i dëmtuari vrapon në drejtim të dëmtuarve B dhe V. K dhe menjëherë sulmohet nga i pandehuri A dhe kur provon ta thirr policinë me telefon, aty menjëherë reagon i pandehuri A duke ju drejtuar me fjalët se: “nëse lajmëron policinë do të mys, sot qe kaq kurse pas sodit kom me te vra” .

- Me çka ka kryer veprë penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 80 par.1 të KPRK-së, neni 188 par.2 dhe nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, neni 185 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarve A. K dhe N. K iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit A. K për veprën e parë penale i përcakton dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Për veprën e dytë penale ia përcakton dënimin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

Për veprën e tretë penale ia përcakton dënimin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

Andaj gjykata konform nenit 80 par.1 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari A. K që në emër të paushall gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarin N. K për veprën e parë penale ia përcakton dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Për veprën e dytë penale ia përcakton dënimin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

Andaj gjykata konform nenit 80 par.1 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari N. K që në emër të paushall gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Palët e dëmtuara B, V dhe B K që të gjithë nga fshati Doberdol Komuna Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP.II.Nr.2139/2015 të datës 07.12.2015, kundër të akuzuarve A.K dhe N.K që të dy nga fsh.Doberdol Komuna Pejë për shkak se në bashkëveprim kishin për të kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 dhe nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari N.K ka kryer vepër penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPRK-së dhe i akuzuari A.A ka kryer dy vepra penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP.II.Nr.2139/2015 të datës 07.12.2015, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën

dhe të akuzuarve iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe të akuzuarit A.K dhe N.K secili veç e veç ka deklaruar se i kanë kuptuar të gjitha pasojat e pranimin të fajësisë dhe se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se meqenëse të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë duke i kuptuar pasojat e pranimin të fajësisë në mënyrë vullnetare dhe pa ndonjë presion, ka konsideruar se i njëjti pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat të lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarve vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i policit Nimon Rexhaj me numër 2015-DA-2819 i dt.12.12.2015, raporti mjekësor në emër të të dëmtuarit Visar Kastrati të lëshuar nga spitali regjional i Pejës me dt.12.11.2015, lista mbi konfiskimin e dt.12.11.2015, aktvendimin mbi pezullimin e përkohshëm të procedurës e dt.30.11.2015, shënimi zyrtar i dt.30.11.2015 dhe i dt. 07.12.2015, deklarata e të dëmtuarve B.V.K. K të dhëna në polici me dt.12.11.2015 dhe në prokurori me dt.30.11.2015 dhe me dt.07.12.2015, deklarata e të pandehurve të dhëna në polici me dt.12.11.2015 si dhe të shikohen foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, patën sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, për gjykatën nuk ka të dhëna se të njëjtit kanë ra ndesh me ligjin më parë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarit e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit e lartcekur i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPRK-së, i obligoi të akuzuarit e lartcekur që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarit që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 463 të KPPRK-së gjykata i udhëzoi palët e dëmtuara B.V dhe B K që të gjithë nga fshati Doberdol Komuna Pejë, që për kërkesën e tyre pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.845/15.

Bashkëpunëtore profesionale
Besa Dervishaj

GJ Y Q T A R I
Ahmet Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.